



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.402/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) - Guxo, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 09.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)), Anr.402/2025 e datës 06.02.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 ( dymijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 06.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.402/2025, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK, më datë 05.02.2025, në orën 18 e 30, ka vërejtur se në rastin e mbajtjes së tubimit, në fshatin Shkabaj, përkatësisht në SHFMU "Dituria" në Prishtinë, ka vërejtur se subjekti politik LVV me këtë veprim, ka bërë shkelje të nenit 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Parashtruesi i ankesës si provë, ka bashkangjitur fotografi nga tubimi i lartcekur. .

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se nuk ka dëshmi të qarta dhe bindëse, ku në bazë të provave të bashkangjitura ankesës, theksojnë se në provën e parë vërtetohet se është tubimi i LVV-së, por nuk vërtetohet pjesëmarrja e fëmijëve, ndërsa në provën e dytë theksojnë se vërtetohet pjesëmarrja e fëmijëve, por nuk vërtetohet se është tubimi i LVV-së. Po ashtu në

përgjigje në ankesë theksojnë se në provën e tretë të bashkangjitur në ankesë vërtetohet se i përket tubimit të LVV, mirëpo nuk vërtetohet pjesëmarrja e fëmijëve.

Andaj kërkojmë nga PZAP-i, që ankesën ta hedh poshtë si të pa bazuar dhe të njëjtave mos te ju fal besimin sepse me to nuk mund të arrihet deri tek e vërtete, duke pasur parasysh provat dhe dëshmitë e ofruara.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli ka gjetur se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se në tubimin e mbajtur për fushatën zgjedhore të subjektit politik LVV, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore*".

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik LVV në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga fotografitë e ofruara si dëshmi nga subjekti politik LDK shihet se tubimi në fjalë është i organizuar nga subjekti politik LVV sepse shihen edhe simbolet e këtij subjekti dhe po në të njëjtën tubim kanë marrë pjesë edhe fëmijë, me qëllim të përfitimit të votave.

Andaj paneli vlerëson se veprimet tilla janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.402/2025 datë 09.02.2025

Kryesuese e Panelit  
Kujtim Pasuli



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.